



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë, _____.2016
Nr. Dok. 201502410/2

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e trefishit të pagesës për shkak të verbërisë për studentin K. I, banues ne Skrapar*

Drejtuar: Z. Nesim Spahiu

Kryetari i Bashkisë

SKRAPAR

I Nderuar Kryetar,

Pranë institucionit të Avokatit të popullit ka paraqitur ankesë qytetari Sh.I, i cili ankohet ndaj Bashkisë Skrapar, lidhur me përfitim e pagesës së verbërisë për djalin e tij Klodian Idrerhai, asistent avokat pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për vitin mësimor 2015-2016, Tiranë.

Konkretisht, pretendohet se djali, K. I, gëzon statusin e të verbrit dhe aktualisht është i regjistruar si asistent avokat pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë, për vitin mësimor 2015 – 2016, duke ndjekur programin e trajnimit fillestar, "Për profesionin e Avokatit", por megjithëse sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2365, datë 26.11.2008, pika 8, përfiton pagesë për shkak të verbërisë, kjo gjë i është mohuar nga Bashkia Skrapar.

Për sa më sipër sqarojmë se:

K. I, sipas pikës 8 të Udhëzimit nr. 2365, datë 26.11.2008, i cili përcakton se: ***"Studentët e verbër të shkollave të larta, ose që përfshihen në studimet pasuniversitare, ose të verbrit që kanë mbrojtur graden "Doktor i shkencave", përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, në masën 26.100lekë në muaj"***

Nga kjo dispozitë duket qartë se personi është përfitues i trefishit të pagesës për shkak të verbërisë.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se

"Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

R E K O M A N D O J M Ë:

Përfitim e trefshit të pagesës së grupit të invaliditetit për shkak të verbërisë për vitin arsimor 2015-2016, bazuar në VKM Nr.277 datë 18.07.1997 i ndryshuar, "Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit".

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një*

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI